



Në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 8, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-032,të datës 29.08.2011, neni 34 dhe 35, Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Nr.03/L-068, neni 5, paragrafi c ,Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.10/2018,Për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm,vendimeve nr.677/2019 dhe 678/2019 të Inspektoratit të Punës,Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec ri shpall:

Konkurs

Për plotësimin e vendit të lirë të punës me kuadër profesional të arsimit, për vitin shkollor 2019/20.

1.SHFMU"Gëzim Hamza-Piktori" në Rahovec

Një mësimdhënës/e për lëndën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe për 15 orë mësimi në javë

Kushtet për konkurim:

Për vendin e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional, sipas U.A. 10/2018(Udhëzimi Administrativ për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm), ndërsa kualifikimet tjera që nuk janë në përputhje me këtë udhëzim administrativ nuk do të merren në konsideratë.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen duke ia bashkangjitur dokumentet përkatëse , në zyrat e DKA-së.

Dokumentet e nevojshme:

- Kopjen e diplomës së fakultetit të kryer, të noterizuar,
- Kopjet e certifikatave të trajnimeve me bazë në shkollë.
- Kopjen e ekstraktit të lindjes.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime

Informata me rëndësi:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes.

Dokumentet pranohen deri më datë,28.08.2019, deri në ora 15.00.

Intervistimi me shkrim i kandidatëve bëhet më datën, 30.08.2019 në SHMLP"Selaudin Mullaabazi-Mici" duke filluar nga ora 09.00.

Intervistimi me gojë i kandidatëve do të realizohet me datë, 02.09.2019, në DKA duke filluar nga ora 09.00.

Rahovec,
14.08.2019



Avni Morina,Drejtor

Avni Morina